



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____.____. 2020

PËR

**ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN
E PËRFAQËSIMIT TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE
NË KËSHILLIN KONSULTATIV TREPALËSH RAJONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 6, neni 200/1, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal (KKTR) është organ rajonal konsultativ trepalësh, në nivel qarku, me përfaqësues të organizatave të punëdhënësve, të organizatave të punëmarrësve dhe përfaqësues të strukturave shtetërore në nivel qarku. Krijohen dymbëdhjetë këshilla konsultativë trepalësh rajonalë në shkallë vendi. 12
2. Këshillat konsultativë trepalësh rajonalë zhvillojnë konsultime për çështje me rëndësi rajonale, në interes të përbashkët të palëve, marrin vendime me konsensus dhe i bëjnë rekomandimet përkatëse këshillit të qarkut dhe/ose këshillit bashkiak, sipas kompetencës territoriale.
3. Çdo organizatë përfaqësuese e punëmarrësve dhe e punëdhënësve, e krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe administrata shtetërore në nivel qarku, duhet të vendosë në dispozicion të Këshillit Konsultativ Trepalësh Rajonal të gjitha informacionet dhe të dhënat e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë dhe mirëfunksionimin e tyre.

4. Çdo këshill konsultativ trepalësh rajonal kryesohet nga prefekti dhe ka në përbërje:
 - a) prefektin, tre kryetarët e bashkive me numrin më të madh të banorëve dhe drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Punësimit.
 - b) Pesë anëtarë, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe pesë anëtarë të organizatave të punëmarrësve.

Anëtarët zëvendësues marrin pjesë në seancat e Këshillit në mungesë të përfaqësuesve anëtarë.

5. Përzgjedhja e anëtarëve përfaqësues të organizatave sindikale dhe të punëdhënësve përcaktohet sipas treguesve të përcaktuar në pikën 4 dhe 5, të nenit 200/1 të Kodit të Punës. Emërimi i tyre bëhet nga prefekti, sipas propozimeve të vetë organizatave.
6. Kryetari i KKTR-së ka këto detyra:
 - a) Të drejtojë mbledhjet e Këshillit;
 - b) Të miratojë rendin e ditës, raportin përfundimtar të mbledhjeve, si dhe programin vjetor të Këshillit mbi bazën e mirëkuptimit mes palëve;
 - c) Të informojë këshillin e qarkut ose këshillin bashkiak për rekomandimet e tij, si dhe për mendimet e organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve në shkallë qarku;
 - ç) Të caktojë nënkryetarët e palëve, në konsultim me përfaqësuesit e organizatave punëmarrëse dhe punëdhënëse, anëtarë të Këshillit.

7. KKTR-ja, në çdo qark, mblidhet në përputhje me programin e miratuar ose me kërkesën me shkrim të çdo pale, sipas përcaktimit të bërë në rregulloren e brendshme të funksionimit, por jo më pak se katër herë në vit.
8. Anëtarët e Këshillit, për çështjet që do të diskutohen, kanë të drejtën e këshillimit paraprak dhe e shprehin qëndrimin e tyre nëpërmjet nënkryetarit të palës.
9. Çdo këshill harton rregulloren e vet të brendshme mbështetur në specifikat e çdo qarku. Mënyra e organizimit dhe përgatitja e dokumentacionit të mbledhjeve të KKTR-së përcaktohet në rregulloren e brendshme të miratuar prej tij.
10. Për funksionimin e Këshillit caktohet një sekretariat i përbërë nga tre nëpunës të administratës së Drejtorive Rajonale të Punësimit.
11. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit, për çdo mbledhje të bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi.

12. Shpenzimet për shpërblimin e anëtarëve të Organizatave të Punëdhënësve dhe Punëmarrësve do të përballohen nga buxheti i 12 Zyrave të Punësimit në qarqe (Instrukcioni Përgjegjës për Punësimin dhe Aftësi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë) ndërsa për shpërblimin e anëtarëve për përfaqësuesit e shtetit do të përballohen nga fondet e miratuara për secilën Institucion.
13. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe prefektët e qarqeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA